

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda**, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.N, nga P rr.“Sh Rr” nr....., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.316/15 të dt.28.10.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit të dytë me dt.27.12.2016, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av.Bahtir Troshupa, sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari Sh.N**, i biri i A dhe Xh, e gjinisë G, i lindur me dt.*data e lindjes*, në P, ku edhe tani jeton në rr.”Sh Rr” nr.227, te shkolla normale, student, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr të ID-së *numer i ID*.

## ËSHTË FAJTOR

### Sepse

Me dt.30.05.2016, rreth orës 12:00, në P, në lagjen e G, pas një mosmarrëveshje me tani të dëmtuarin F.R, ka përdor armën e zjarrit, në atë mënyrë që është afruar te automjeti i të dëmtuarit i markës “BMW”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit. ...-...-..., nga ana e pasagjerit, ka kërkuar që të dalë nga automjeti e kur i dëmtuari është larguar me automjetin e tij ka shtënë 1 (një) fishek në ajër nga pistoletat me gas e markës “Petro Bereta” e kalibrit 7.65 mm, me numër serik EJC-1590109, e cila së bashku me 5 (pesë) fishek të kalibrit të vogël i është konfiskuar përkohësisht nga Policia, e të cilën i pandehuri e ka mbajtur pa leje të organit kompetent dhe e ka përdorë duke shkelur dispozitat e Ligjit për Armë.

-me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 i KPRK-së.

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 46, 50, 51, 69, 73, 74 dhe 375 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 367, 368, 450, 453 dhe 463 të KPRK, e:

## GJYKON

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, dhe

**ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 500 (pesëqind) Euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari F.R për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarit i konfiskohet revolva e tipit "Petro Bereta" e kalibrit 7.65 mm, me numër serik EJC-1590109, dhe 5 (pesë) fishek të kalibrit të vogël, si mjet ky me të cilin është kryer vepra penale, dhe të njëjtat të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/L.nr.316/15 të dt.28.10.2016, kundër të akuzuarit Sh.N, për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 i KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit dytë gjyqësorë, me dt.27.12.2016, në të cilën i akuzuari, e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale me të cilën është akuzuar.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit Sh.N, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 i KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që ta merr parasysh pranimin e fajësisë ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë të ligjshme, njëherit i propozoj gjykatës që të konfiskohet arma e sekuestruar nga Policia e Kosovës.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.N av.B.T në fund ka deklaruar se nga vetë deklarimi i të pandehurit për pranimin e veprimeve dhe të përgjegjësisë penale u vërtetua fakti se i njëjti e ka përdorë armën, pra ka shtënë në ajër, mirëpo i njëjti ka vepruar nën rrethanat e mbrojtjes e posaçërisht ka pasur një tronditje të thellë dhe frikë të jashtëzakonshme nga pasojat e tani të ashtuquajturave palë të dëmtuara. Ka qenë një shkrepje në ajër, arma ka qenë e vjetër dhe është bllokuar as nuk ka pas vullnet me përdorë e as nuk ka pas mundësi me përdorë për të krijuar pasoja. Nga vendi i ngjarjes është larguar dhe ka kërkuar ndihmën e punëtorëve të sigurimit të universitetit me qëllim të shmangjes së rrezikut, ka bashkëpunuar me policinë, ka dorëzuar armën dhe nga ajo kohë as nuk ka pasur kontakt me të dëmtuarit dhe as nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin. Këto rrethana si dhe fakti që e kaluara e tij është e pastër, rrjedh nga një familje

që i ka kontribuar drejtësisë, dhe është frymëzuar për drejtësi, dhe pa dënim vetë fakti që gjendet në gjykatë është një masë që do të ndikojë jashtëzakonisht në përmirësimin e tij, pavarësisht që armën e ka përdorë kundër vullnetit të tij. Në këtë kontest gjykatës i propozon që konform ligjit të bëjë një zbritje të jashtëzakonshme të dënimit dhe konform praktikës gjyqësore dhe rrethanave të rastit të pandehurit të shqiptojë dënim alternativ.

I akuzuari Sh.N në fund ka deklaruar se shpreh keqardhje dhe pendim të thellë për këtë që i ka ndodhë, asnjëherë deri më tani nuk ka pas as problemin më të vogël me askënd, ngjarja ka ndodhur papritur ashtu siç ka ndodhur, dhe e ka lutur gjykatën që ti vlerësojë të gjitha këto rrethana me rastin e shqiptimit të çfarëdo dënimi, si dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen asnjëherë nuk do të përsërisë veprime të ngjashme.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë që nga fillimi i kësaj procedure penale si dhe sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i tij për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris asnjëherë këto veprime, gjendjen e tij ekonomike, ashtu që të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 50 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlíkueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, është lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë duke pas për bazë faktin se i dëmtuari nuk ka qenë prezent në seancën e shqyrtimit të dytë gjyqësore, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë, e po ashtu deri më tani me asnjë parashtrësë paraprakisht nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurve për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e revoles është marrë konform nenit 375 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.632/16, dt.27.12.2016**

**Procesmbajtësja**  
Mybera Latifi

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.